

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6260
E mërkurë, 10 mars 2021
çmimi 0.40 €

Meliza Haradinaj-Stublla jep dorëheqje nga pozita e kryediplomates I FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA BËHET KONTRIBUUESE E PAQES, SIGURISË DHE STABILITETIT NË BOTË I FAQE 4-5

FSK-ja NIS MISIONIN E PARË USHTARAK JASHTË VENDIT



Kosova ka nisur kontingjentin e parë ushtarak jashtë vendit. Nisja e pjesëtarëve të FSK-së në operacionin e parë paqeruajtës është vlerësuar historike për Kosovën. Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës

kanë vlerësuar se në këtë mënyrë Kosova po bëhet kontribuuese e paqes përkrah partnerëve dhe miqve të saj. Ata kanë shprehur mirënjohjen e lartë për mbështetjen e pakursyer të ShBA-së për të

arriturat e deritashme të FSK-së në forca moderne ushtarake me standardet më të larta profesionale. Kontingjenti i FSK-së, i nisur për Kuvajt, do të jetë pjesë e Gardës Kombëtare të Ajovës

LUTFI HAZIRI SOT SHPALL KANDIDATURËN PËR KRYETAR TË LDK-së I FAQE 3



VETËM GJATË PANDEMISË JANË KRYER MBI 400 MIJË SHËRBIME NË KLINIKËN E ONKOLOGJISË I FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KOMUNITETET JOSERBE ANKOHEN NË GJYKATËN SUPREME F. 3

TOMË GASHI PËRGATIT KALLËZIM PENAL DHE PADI CIVILE NDAJ DICK MARTYT F. 4-5

POLICIA E KOSOVËS PRANON PESË QEN PËR NJËSINË "K9" NGA UNDP-ja F. 7

HARADINAJ TAKON AMBASADOREN E MAQEDONISË, FLASIN PËR ZHVILLIMET NË KOSOVË F. 8

EKONOMI



QEVERIA MERR VENDIM PËR SHPRONËSIMIN E DISA TOKAVE PËR AUTOSTRADA F. 9

NDALOHET NJË AUTOMJET ME 435 KILOGRAMË DUHAN TË KONTRABANDUAR F. 9

SPORT

SOT ZHVILLOHEN TRI NDESHJE NË SUPERLIGË, DY NESËR F. 14

Rikthehen portretet e ish-presidentëve Bush dhe Clinton në hollin e Shtëpisë së Bardhë

WASHINGTON, 9 MARS - Shtëpia e Bardhë ka rivendosur portretet zyrtare të ish-presidentëve George W. Bush dhe Bill Clinton, pasi ato ishin hequr në korrikun e kaluar gjatë administratës së Trumpit, ka thënë një zyrtar për "CNN". "Portretet janë sërish në ekspozitë", ka thënë zyrtari. Fotografitë ishin hequr korrikun e kaluar dhe ishin zëvendësuar nga dy portrete të ish-presidentëve republikanë

që shërbyen më shumë se një shekull më parë. Tradita e Shtëpisë së Bardhë bën thirrje që portretet e presidentëve më të fundit amerikanë të vendosen në hyrje të rezidencës ekzekutive, të dukshme për të ftuarit gjatë ngjarjeve zyrtare. Sidoqoftë, Shtëpia e Bardhë në krye me Trumpin kishte zhvendosur portretet e Clintonit dhe Bushit në Sallën e Darkës së Familjes së Vjetër, një

dhomë e vogël, e përdorur rrallë dhe që nuk shihet nga shumica e vizitorëve. Sidoqoftë, tani që ati janë kthyer në vendndodhjen e tyre të mëparshme, fotografitë ka shumë të ngjarë të shihen nga presidenti Joe Biden teksa ai zbret shkallëve nga rezidenca private e katit të tretë. Portreti zyrtar i ish-presidentit Barack Obama nuk është zbuluar dhe është e paqartë se kur do të përfundojë ose kur do të varet.



PE-ja ia heq imunitetin liderit katalanas

STRASBURG, 9 MARS - Parlamenti Evropian (PE) i ka hequr imunitetin liderit katalanas Carles Puigdemont dhe dy kolegëve të tij, duke mundësuar potencialisht ekstradimin e tyre në Spanjë. Në tri votime të ndara për Puigdemont, ish-ministrin rajonal të Shëndetësisë Toni Comin, dhe ministren e Edukimit Clara Ponsati, 400 apo më shumë ligjvënës të Bashkimit Evropian kanë votuar për heqje të imunitetit, 248 kanë votuar kundër dhe 45

kanë abstenuar. Puigdemont dhe Comin janë zgjedhur në Parlamentin Evropian më 2019, derisa Ponsati ka fituar një ulëse vitin e kaluar. Ulëset e tyre u kanë dhënë imunitet nga ndjekja penale, mirëpo me kërkesë të gjyqësorit spanjoll parlamenti ka nisur hetime për heqje të imunitetit. Puigdemont, ish-lider i Qeverisë rajonale të Katalonjës, bashkë me Comin kanë udhëtuar në Belgjikë, pasi autoritetet patën shtypur një



referendum të mbajtur në tetor të vitit 2017 për pavarësinë e Katalonjës. Ponsati tani jeton në Skoci. Avokati i Puigdemontit në Spanjë Gonzalo Boye ka thënë se klienti i tij do ta apelojë vendimin e asamblesë në Gjykatën Supreme të BE-së në Luksemburg. Qeveria spanjolle, e cila ka kërkuar të akuzojë këta persona për rebelim dhe kryengritje, ka mirëpritur menjëherë vendimin dhe e ka konsideruar fitore për sundimin e ligjit.

OKB-ja kritikon Zvicrën për ndalimin e mbulesës së fytyrës



NJU-JORK, 9 MARS - Vota në Zvicër për ta ndaluar mbulesën e fytyrës, duke përfshirë edhe mbulesat për tërë trupin apo për tërë fytyrën, të cilat përdoren nga gratë myslimane, shkel të drejtat e njeriut, ka thënë Zyra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR). "Zvicra është duke iu bashkuar një numri të vogël të shteteve, ku diskriminimi aktiv ndaj grave myslimane është i sanksionuar me ligj. Dhe kjo është tejet fatkeq", ka thënë zëdhënësja e OHCHR-

së, Ravina Shamdasani. Rreth 51.2 për qind e popullit zviceran ka votuar të dielën në të mirë të ndalesës, e cila shënjestron gratë që vendosin burka dhe nikab, transmeton "DPA". Ndonëse në letër ndalesa vlen për të gjitha llojet e mbulesave në përgjithësi, kjo votë është shtyrë përpara nga grupet e ekstremit të djathtë dhe ato kundër islamit, të cilat nuk e kanë fshehur asnjëherë qëndrimin e tyre për këtë çështje. Qeveria federale, në anën tjetër, ka bërë fushatë kundër

ndalesës. Ndalesa të tilla vlejné edhe në Austri, Holandë dhe Francë. "Gratë nuk duhet të detyrohen t'i mbulojnë fytyrat e tyre. Në të njëjtën kohë, ndalesa ligjore për mbulesa të fytyrës do t'ua kufizojë atyre të drejtën për të praktikuar fenë apo besimet e tyre dhe kjo ka ndikim të madh në të drejtat e njeriut", ka thënë Shamdasani. Sipas ligjit, liri të tilla mund të kufizohen vetëm për ta mbrojtur sigurinë publike, shëndetin, moralin, apo të drejtat themelore të të tjerëve.

Gjermania, shënjestër kryesore e dezinformimit rus

BRUKSEL, 9 MARS - Rusia ka shënjestruar Gjermaninë më shumë se çdo vend tjetër të Bashkimit Evropian në përpjekjet e saj për dezinformim, tregon një raport i ri i BE-së. "Asnjë shtet tjetër anëtar i BE-së nuk po sulmohet më dhunshëm sesa Gjermania", është thënë në raportin e publikuar të martën nga shërbimi

diplomatik i BE-së në Bruksel. Raporti ka theksuar se "fushatat sistematike" kanë nisur në nivelin politik dhe përmes mediave të lidhura me Kremlinin. Raporti vjen në kohën kur Shtetet e Bashkuara akuzojnë Rusinë për një fushatë të koordinuar dezinformimi, me qëllim minimin e besimit në

vaksinat amerikane kundër koronavirusit. Rusia e ka mohuar përfshirjen në fushata dezinformimi. BE-ja ka thënë se që nga fundi i vitit 2015 në Gjermani janë mbledhur mbi 700 raste dezinformimi, por nuk jep më shumë detaje rreth tyre. Franca ka qenë shënjestër më shumë se 300 herë, ndërsa Italia rreth 170 herë.



Përfaqësuesit e disa komuniteteve kanë sfiduar vendimin e PZAP-it në Gjykatë Supreme

Komunitetet joserbe ankohen në Gjykatën Supreme

Kandidatja për deputete e Unionit Socialdemokrat, Duda Balje, kandidati për deputet i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, dhe Adrijana Hoxhiq, udhëheqësja e "Komuniteti i Bashkuar - Adrijana Hoxhiq" kanë dorëzuar të martën ankesat e tyre në Gjykatën Supreme për ta sfiduar vendimin e PZAP-it në lidhje me anulimin e votave në disa komuna me shumicë serbe. Me këtë rast, ata kanë thënë se presin përgjigje pozitive nga kjo gjykatë



vend në Kuvend. "Ne thirrmi në emrin e Kushtetutës për t'i mbrojtur të drejtat tona. Po besoj se do të sigurojmë një ulësë", ka thënë ajo.

Edhe Veton Berisha pret që Gjykata Supreme të marrë vendim meritore për ankesat e tyre. "Ne sot si Parti Liberale Egjiptiane, bashkë me partnerët tjerë nga komunitetet, e kemi deponuar një ankesë në Gjykatën Supreme dhe kemi premtuar që do t'i shkojmë procesit deri në fund. Dje kemi marrë një vendim nga PZAP dhe jemi të kënaqur për bazën e ankesës sonë dhe bazën e shqetësimit ku nga PZAP-i është konfirmuar se ka pasur keqpërdorim të votave dhe vendimi është meritore. Sot kemi ardhur për ta ankimuar vendimin e PZAP-it për shkak se PZAP-i ka marrë vendim për disa komuna", ka thënë ai, duke shtuar se ky komunitet po e ruan sovranitetin e Kosovës. "Unë mendoj se si dukuri duhet të anulohet në tërësi. Ne e kemi ruajtur sovranitetin e Kosovës, e kemi parandaluar një të keqe të madhe dhe e kemi parandaluar që si dukuri të ndodhë përsëri.

Egjiptianët janë dëmtuar me një mandat. Edhe me vendimin e djeshëm ende nuk do të jem pjesë e Kuvendit. Por, nëse pranohet kjo ankesë, unë do të jem në Kuvend. Unë do të doja të largohesha nga votuesit, por jo nga Serbia", ka thënë ai.

Kurse Adrijana Hoxhiq, udhëheqësja e subjektit politik boshnjak "Komuniteti i Bashkuar - Adrijana Hoxhiq", e ka vlerësuar skandaloz vendimin e PZAP-it për anulimin e votave për partitë e komunitetit boshnjak në komunat me shumicë serbe. Ajo i është drejtuar Gjykatës Supreme për ta kundërshtuar vendimin e PZAP-it i cili ka anuluar mbi 4 200 vota që i kishte siguruar në komunat e banuara me shumicë serbe. Hoxhiq ka paralajmëruar se nëse Supremja nuk hedh poshtë vendimin e PZAP-it do të shfrytëzojë edhe instanca të tjera gjyqësore, duke aluduar në Gjykatën Kushtetuese dhe në mekanizmat ndërkombëtarë. "Absolutisht do të shkojmë deri në fund. Do t'i shfrytëzojmë të gjitha institucionet dhe resurset që i kemi brenda Kosovës. Por, në

qoftë se kjo nuk jep rezultat, ku do të respektohej e drejta e njeriut për të votuar sipas vullnetit, do të shkojmë edhe më tutje, do t'i shfrytëzojmë edhe mekanizmat e institucioneve jashtë vendit", ka thënë Hoxhiq. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia një ditë më parë ka anuluar në tërësi votat në zgjedhjet e 14 shkurtit për subjektet politike boshnjake në

komunat e banuara me shumicë serbe, siç janë Zubin Potoku, Shtërpca, Ranillugu, Graçanica, Parteshi, Klllokoti, Novobërda, Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Leposaviqi. Me këtë vendim PZAP-i ka anuluar 4 205 vota të cilat i kishte siguruar subjekti politik boshnjak, i udhëhequr nga Adrijana Hoxhiq, në komunat e banuara me shumicë serbe.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 MARS - Kandidatja për deputete e Unionit Socialdemokrat, Duda Balje, dhe kandidati për deputet i Partisë Liberale Egjiptiane, Veton Berisha, kanë dorëzuar të martën ankesë në Supreme për anulimin e votave edhe në disa komuna, përveç atyre që janë anuluar. Pas dorëzimit të ankesës, Balje ka thënë se janë të kënaqur me vendimin e PZAP-it, por pret që edhe Supremja t'i kthejë përgjigje pozitive. "Ne dje kemi marrë vendimin e PZAP-it dhe unë si përfaqësuese e boshnjakëve jam e kënaqur. Kemi pasur dy pika të paqarta. Ne e kemi bërë një analizë dhe kemi paraqitur si dëshmi", ka thënë ajo. Balje ka thënë se beson që pas vendimit të Supremes do të sigurojë një

Përfundon rinumërimi i votave me kusht dhe të diasporës për kandidatët e AAK-së

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është duke u zhvilluar procesi i rinumërimit të disa vendvotimeve të caktuara pas vendimit të PZAP-it, pas ankesave të parashtruara nga kandidatët e subjekteve të ndryshme politike. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për medie ka treguar se ka përfunduar rinumërimi i votave me kusht dhe atyre me postë

për kandidatët e AAK-së. "Dje kemi filluar numërimin e votave me kusht dhe sot në mesditë kemi përfunduar edhe numërimin e votave që kanë ardhur jashtë vendit. Kështu ka qenë vendimi i PZAP-it për t'i rinumëruar vetëm votat e kandidatëve të subjektit politik AAK", ka deklaruar Elezi, duke shtuar se në QNR janë duke u numëruar vendvotime të tjera sipas vendimeve të PZAP-it.

Lutfi Haziri sot shpall kandidaturën për kryetar të LDK-së

GJILAN, 9 MARS (ER) - Kryetari i Degës së LDK-së në Gjilan, Lutfi Haziri, do ta shpallë sot (e mërkurë) kandidaturën për kryetar të partisë në komunën që drejton. "Ju njoftojmë se kryetari i Degës së LDK-së në Gjilan, Lutfi Haziri, më 10 mars, në orën 13:00, do ta shpallë zyrtarisht kandidaturën për kryetar të LDK-së në nivel qendror. Ftoheni të merrni pjesë në

konferencën për media të Lutfi Haziri, në selinë e LDK-së në Gjilan", ka njoftuar Dega e LDK-së në Gjilan.

Lidhja Demokratike e Kosovës në anën tjetër ka konfirmuar tri kandidatura zyrtare për kryetar të partisë. Anton Quni, Lumir Abdixhiku dhe Lutfi Haziri tashmë zyrtarisht do të garojnë për të parin e LDK-së në Kuvendin X Zgjedhor që do të mbahet këtë të diel.





KOSOVA BËHET KONTRIBUUESE E PAQES, SIGURISË DHE STABILITETIT NË BOTË

FSK-ja nis misionin e parë ushtarak jashtë vendit

Kosova ka nisur kontingjentin e parë ushtarak jashtë vendit. Nisja e pjesëtarëve të FSK-së në operacionin e parë paqeruajtës është vlerësuar historike për Kosovën. Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë vlerësuar se në këtë mënyrë Kosova po bëhet kontribuuese e paqes përkrah partnerëve dhe miqve të saj. Ata kanë shprehur mirënjohjen e lartë për mbështetjen e pakursyer të ShBA-së për të arriturat e deritashme të FSK-së në forca moderne ushtarake me standardet më të larta profesionale. Kontingjenti i FSK-së, i nisur për Kuvajt, do të jetë pjesë e Gardës Kombëtare të Ajovës

Bashkuara të Amerikës dhe të aleatëve tanë të tjerë. Pra, që të jemi të qartë, kushdo që kërcënon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët tanë të tjerë ka kërcënuar edhe Republikën e Kosovës. Në Kosovë, Amerika dhe aleatët e tjerë gjithnjë do ta gjejnë aleatin e tyre më lojal", ka thënë Osmani. Edhe kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka thënë se ndihet

i privilegjuar që në mandatin e kësaj qeverie, një kontingjenti i FSK-së është nisur në misionin e parë paqeruajtës në Kuvajt bashkë me Gardën Kombëtare të Ajovës. "Pjesëmarrja në misione paqeruajtës, bashkë me aleatin tonë kryesor strategjik, ShBA-në, është ndër hapat më të rëndësishëm historikisht që ka bërë Kosova si shtet dhe si Forcë e Sigurisë, drejt integritetit të

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 9 MARS - Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) të martën ka nisur misionin e parë paqeruajtës jashtë vendit. Në ceremoninë e nisjes së kontingjentit të parë për në Kuvajt, liderët institucionalë e kanë vlerësuar historik fillimin e këtij operacioni. Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka deklaruar se në këtë ditë FSK-ja po përmbushet edhe një objektiv të saj. "Programi i partneritetit shtetëror me ushtrinë amerikane ka qëllim afatgjatë dhe ka për qëllim krijimin dhe zgjerimin e partneritetit me FSK-në, në funksion të promovimit të sigurisë rajonale dhe më gjerë. Sot një nga këto objektiva po nis përmbushjen e tij", ka thënë

Osmani. Sipas saj, misioni paqeruajtës është bërë i mundur falë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Ky mision nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e Ushtrisë Amerikane. Prandaj, të nderuar përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, këta djem janë edhe djemtë tuaj. Misioni juaj është edhe misioni ynë! Është paqja dhe besimi në vlera të përbashkëta që na bëri bashkë dhe ato t'i bëjmë të mundshme", ka theksuar Osmani.

Ajo ka deklaruar se kushdo që kërcënon ShBA-në ka kërcënuar edhe Kosovën. "Siç e kemi dëshmuar edhe më parë, ne nuk dimë të zbrapsemi. Usharët tanë do të jenë kudo dhe kurdo që rrezikohen interesat tona e vlerat në të cilat besojmë, por edhe ato të Shteteve të



plotë në strukturat euroatlantike. Gjithmonë krenar me djemtë dhe vajzat e FSK-së!", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Në ceremoninë e mbajtur në kazermën "Adem Jashari" ka folur edhe ministri në detyrë i Mbrojtjes, Anton Quni, i cili ka thënë se misioni në Kuvajt është mundësi që Kosova të kontribuojë për paqe përkrah partnerëve strategjikë. "Kjo ngjarje shënon një moment të veçantë për Kosovën që, përveç një mundësie historike, ku FSK-ja radhitet përkrah ShBA-së dhe partnerëve strategjikë për të kontribuar në paqen dhe sigurinë në nivelin ndërkombëtar. Njëkohësisht, është një reflektim që të shohim prapa dhe ta shprehim falënderimin dhe mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer nga të gjithë partnerët tanë, të cilët

arritën në Kosovë 22 vjet më parë me të njëjtin mision, për të vendosur dhe ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë", ka thënë Quni.

Kurse komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Rrahman Rama, ka vlerësuar se kjo ditë është bërë realitet edhe falë profesionalizmit të pjesëtarëve të FSK-së. "Sot është ditë historike për Kosovën. Sot Kosova zyrtarisht po bëhet kontribuuese e misionit të paqes përkrah partnerëve dhe miqve tanë. Kjo e arritur është falë pjesëtarëve të FSK-së. Jam krenar që jam komandant i Forcës", ka deklaruar ai.

Rama ka thënë se këta ushtarë do ta përfaqësojnë Kosovën në mënyrë të dinjitetshme. "Të dashur ushtarë të FSK-së, ju jeni duke zbatuar një mision fisnik në mbështetje të paqes. Do të jeni

krenarë pasi që në këtë mision jetësoni një synim tonin për të cilën shumë gjenerata sakrifkuan. Jam i bindur se do të shërbeni me profesionalizëm dhe do ta përfaqësoni Kosovën me dinjitet", ka deklaruar Rama. Përmes një videomesazhi, në ceremoni ka marrë pjesë edhe gjenerali i Gardës Kombëtare i shtetit amerikan Ajova, Ben Correll. Ai ka thënë se ShBA-ja dhe Kosova kanë për synim arritjen e paqes dhe stabilitetit në botë. "Partneriteti ndërmjet gardës sonë dhe FSK-së kontribuon në arritjen e këtij synimi", ka deklaruar ai.

Gjenerali Correll ka vlerësuar se Garda e Ajovës dhe Kosova bashkëpunojnë për dhjetë vjet dhe ka shtuar se ai e di që FSK-ja është e gatshme për këtë mision në Kuvajt. Në nisje të këtij misioni nuk është treguar për numrin e pjesëtarëve të FSK-së

që marrin pjesë në misionin në Kuvajt dhe as profilin e tyre. Nisjen e këtij kontingjenti e kanë përshëndetur edhe liderët e tjerë politikë. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se nisja e misionit paqeruajtës të FSK-së është ditë historike për Kosovën. Në "Facebook" ai ka shkruar se FSK-ja do të shërbejë krahas ushtrisë amerikane, për herë të parë në një mision të tillë. "Një ditë historike për Kosovën, për Ushtrinë e saj, për paqen dhe sigurinë. FSK-ja do të shërbejë krahas ushtrisë amerikane, për herë të parë në një mision të tillë, shumë larg territorit të atdheut. Vendi ynë është rreshtuar me ushtritë e lirisë dhe të paqes e FSK-ja është shembulli më i mirë i ecjes sonë të përbashkët me ShBA-në dhe NATO-n. Faleminderit për shërbimin tuaj! Zoti qoftë me ju!", ka shkruar

Haradinaj.

Kosova ka partneritet shtetëror me Ajovën, Garda Kombëtare e të cilit ndihmon FSK-në për ngritjen e saj dhe për konsolidimin në ushtri. Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht një njësi e saj, do të marrë pjesë në misionin paqeruajtës jashtë vendit krahas ushtrisë amerikane. Kjo marrëveshje dy muaj më parë u ratifikua në Kuvendin e Kosovës dhe shënon për herë të parë angazhimin e trupave të saj në një mision ushtarak paqeruajtës jashtë vendit.

Kontingjenti i FSK-së, i integruar në trupat e Gardës Kombëtare të Ajovës, do të operojë në Komandën Qendrore të Forcave Amerikane, e cila ka përgjegjësi në zonën gjeografike ku përfshihen Lindja e Mesme, një pjesë e Azisë Jugore dhe Afrika Verilindore.



Tomë Gashi përgatit kallëzim penal dhe padi civile ndaj Dick Martyt

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 MARS - Avokati Tomë Gashi ka njoftuar se është duke përgatitur kallëzim penal dhe padi civile ndaj ish-senatorit Dick Marty. Ai ka bërë me dije se Martyn do ta paditë për hyrje në mënyrë klandestine në shtëpinë e Mersin Katuçi, banor i fshatit Gurë të Republikës së Shqipërisë, për të gjetur prova për trafikim të organeve njerëzore. "Në mbrojtje të vlerave kombëtare, në mbrojtje të UÇK-së, kundër Gjykatës Speciale. Në cilësinë e avokatit dhe sipas autorizimit të z. Mersin Katuçi është duke u përgatitur kallëzim penal si dhe padi civile kundër senatorit zviceran, Dick Marty, i cili kishte shkuar në mënyrë klandestine, i maskuar në pronat dhe shtëpinë e z. Mersin Katuçi, në fshatin Gurë të Republikës së Shqipërisë. Edhe pse në shtëpinë e familjes Katuçi nuk ishte gjet asnjë provë për trafikim të organeve njerëzore, Dick Marty e mashtroi, e vuri në lajthim Këshillin e Evropës

duke pretenduar se pjesëtarë të UÇK-së gjatë luftës dhe pas përfundimit të luftës, në shtëpinë e tij kinse kishin mbajtur qindra civilë, shqiptarë, serbë, romë, në mënyrë të kundërligjshme, dhe i kishin torturuar, i kishin vlarë dhe u kishin hequr organet trupore për trafikim ndërkombëtar", ka shkruar Gashi në profilin e tij në "Facebook".

Ai ka treguar se kallëzim penal dhe padi civile do të ngritë edhe kundër ish-kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, Carla Del Ponte. "Kallëzim penal dhe padi civile do të ushtrohet edhe kundër ish-kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, znj. Carla Del Ponte, sepse në librin e saj përdori të dhëna të rrejshme për krimet e pretenduara të UÇK-së e që ishte shfrytëzuar nga Dick Marty për raportin e tij famëkeq. Kallëzim penal do të ushtrohet edhe kundër Jose Pablo Baraybar, kryesues i zyrës për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore në kuadër të UNMIK-ut, i cili, po ashtu, në mënyrë të pa autorizuar-klandestine kishte shkuar te shtëpia e familjes



Katuçi, në kërkim të provave për trafikim të organeve njerëzore të cilat kurrë nuk kishin ndodhur", ka treguar Gashi. Ai ka vlerësuar se duhet t'i nisnin procedurat për zhbërjen e Gjykatës Speciale. "Institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë duhet ta kërkojnë raportin e prokurorit Clint Williamson, dhe meqenëse në

atë raport nuk janë vërtetuar pretendimet dhe deklaratimet e rrejshme të Dick Marty dhe me këtë janë venë në lajthim deputetet e Kuvendit të Kosovës, kur votuan Gjykatën Speciale, atëherë duhet t'i fillojnë procedurat ligjore për zhbërjen - anulimin e Gjykatës Speciale të krijuar me shpifje

dhe deklarime të rrejshme. Është detyrë e Shqipërisë dhe e Kosovës që ta dinë të vërtetën dhe e vërteta është se gjithçka ishte aranzhuar rrejshëm nga Dick Marty, pasojat e të cilave janë Gjykata Speciale, është njollësor i gjithë kombi shqiptar me gënjeshtër të Dick Martyt", ka shkruar Gashi.

Brenda dy vjetësh në Malishevë do të investohen rreth 3 milionë euro në energjetikë

MALISHEVË, 9 MARS (ER) - Nën kryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim përfaqësuesit e KEDS-it, Hasan Oz, Avni Alidemaj dhe Kreshnik Sokolin, me të cilët ka biseduar për projektet në sektorin energjetik.

Në emër të kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Berisha i ka njoftuar të pranishmit me gjendjen e furnizimit të kësaj komune me energji elektrike. "Gjendja me furnizimin me energji elektrike për qytetarët tanë është tejte e keqe. Ky furnizim i dobët po i dëmton amvisëritë shtëpiake, po i dëmton bizneset dhe kompanitë prodhuese të cilat

burim të punës dhe varshmëri e kanë nga energjia elektrike. Kjo gjendje po shkakton edhe mungesë të furnizimit të qytetarëve me ujë të pijshëm, prandaj kërkoj që të fillojmë sa më shpejt realizimin e këtij projekti të rëndësishëm për qytetarët tanë, kurse për të gjitha procedurat sa i përket institucionit komunal dhe sektorëve, zotohem se do t'i përmbushim brenda afatit që kërkohet dhe do t'ju mbështesim e do të bashkëpunojmë plotësisht", ka thënë Berisha.

Ndërsa drejtori për investime në KEDS, Hasan Oz, ka thënë se projekti i kësaj kompanie në fushën energjetike për Malishevën kap vlerën e rreth

tre milionë eurove. "Projekti për investime në infrastrukturën energjetike, për komunën tuaj, kap një vlerë rreth tremilionësh, ku përfshijnë investime të përgjithshme në infrastrukturën energjetike, në tetë njësi dhe katër regjione brenda territorit të komunës, në linjë prej 120 kilometrave, nëse shkon sipas dinamikës së planifikuar. Projekti do të realizohet brenda dy vjetëve dhe gjendja me furnizim të qytetarëve me energji elektrike do të përmirësohet dukshëm dhe problemi do të zgjidhet një herë e mirë", është shprehur Oz. Të dyja palët janë zotuar për bashkëpunim reciprok gjatë implementimit të projektit.



Nënshkruhet memorandumi për vazhdimin e ndërtimit të një çerdheje në Skenderaj

SKENDERAJ, 9 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me ministrin në detyrë të Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, kanë nënshkruar të martën memorandumin e bashkëpunimit për bashkëfinancimin e projektit "Vazhdimi i ndërtimit të çerdhes në lagjen 2 të qytetit të Skenderajt". Në bazë të këtij memorandumi Komuna

e Skenderajt dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal do ta bashkëfinancojnë vazhdimin e ndërtimit të kësaj çerdheje e cila këtë vit do të jetë e gatshme për fëmijët e qytetit tonë. "Në emër të Komunës së Skenderajt falënderoj ministrin Kervan për mbështetjen dhënë komunës sonë për realizim të projekteve që ndikojnë në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve", ka thënë Jashari.



Komuna e Gjakovës kërkon respektimin e masave kundër Covidit

GJAKOVË, 9 MARS (ER) - Shtabi emergjent për menaxhimin e Covid-19 në Komunën e Gjakovës ka zhvilluar të martën mbledhjen e rregullt, në të cilën është diskutuar për gjendjen aktuale në këtë komunë dhe angazhimin e vazhdueshëm të institucioneve relevante për aplikimin e vendimeve të marra nga Qeveria e Kosovës. "Numri i rritur i të infektuarve është shqetësues dhe gjendja tashmë është rënduar. Komuna e Gjakovës është në pjesën e Zonës së Kuqe, që na kategorizon si komunë me rrezikshmëri të lartë. Anëtarët e shtabit emergjent apelojnë që personat e testuar dhe ata të konfirmuar pozitivë me



Covid-19, të qëndrojnë të izoluar, në të kundërtën shkelja e këtyre rregullave paraqet vepër penale", ka njoftuar Komuna e Gjakovës. Sipas këtij njoftimi, Policia e Kosovës dhe inspektorati do të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen e

respektimit në tërësi të manualit për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19. "Gjithashtu, apelohej për durim deri në fillimin e zbatimit të planit shtetëror për vaksinim", ka njoftuar komuna që drejtohet nga Ardian Gjini.

Asambleja e fëmijëve në Gjilan bëhet me kryesi të re

GJILAN, 9 MARS (ER) - Asambleja e Fëmijëve në Gjilan, e cila është themeluar në vitin 2021, ka zgjedhur të martën kryesinë e re. Në dy vjetët e ardhshëm, aq sa zgjatë një mandat, Asamblesë së Fëmijëve do ta udhëheqë Xhengiz Hyzeiri, ndërsa nënkryetarë do të jenë Malvesa Kurti dhe Edine Kazaz, sekretarë Morea Rexhepi, kurse arkëtare Feroza Rashiti. Hanumshahe Rexhepi, zyrtare për të drejtat e fëmijëve, ka thënë se kjo është përbërja e tretë e Asamblesë së Fëmijëve që kur është themeluar kjo organizatë, e cila ka për qëllim afirmimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë, mjedisin ku jetojnë ata si dhe në shoqëri. Rexhepi ka theksuar se Gjilani si

komunë tashmë ka rregulloren për të drejtat e fëmijëve. Asambleja është zëri i fëmijëve dhe këtë privilegj ata duhet ta shfrytëzojnë për të punuar së bashku për të mirën e tyre. Asambleja përbëhet nga përfaqësues të shkollave dhe ka për qëllim ta sigurojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për ta, bashkëpunimin me këshillat drejtues të shkollave, prindërve, nxënësve dhe komunitetin lokal, ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, inkurajimin e tolerancës, solidaritetit dhe demokratizimit, promovimin e vlerave shoqërore dhe të tjera.



Dritan Abazoviqi viziton Prizrenin

Prizren, 9 mars - Zëvendëskryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazoviqi, ka qëndruar të martën në qytetin e

Prizrenit. Lajmin për këtë vizitë e ka bërë me dije Emilija Rexhepi nga komuniteti boshnjak me anë të një postimi

në llogarinë e vet në "Facebook". "Miku ynë, Dritan Abazoviqi, në Prizren", ka shkruar ajo. Bashkë me Rexhepin, në këtë takim


ishite edhe Fidan Jilta, e cila ka siguruar votat për deputete nga Partia Demokratike Turke e Kosovës.



13 të vdekur, 452 të shëruar dhe 444 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë humbur jetën 13 persona si pasojë e infektimit me Covid. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 452 persona dhe janë paraqitur 444 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 2 410 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 444 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 13 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjakovë 3 raste (82, 87, 73 vjeç), Prizren 3 raste (83, 75, 68 vjeç),

Ferizaj 2 raste (71, 69 vjeç), Dragash 1 rast (68 vjeç), Klinë 1 rast (74 vjeç), Pejë 1 rast (81 vjeç), Prishtinë 1 rast (78 vjeç) dhe Suharekë 1 rast (43 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 74 079 raste nga 335 123 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 1 668 raste të të vdekurve. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 452 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 62 650 raste, kurse numri i rasteve aktive është 9 761", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e personave të infektuar me Covid-19 sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 235 raste, Prizren 33 raste, Gjiilan 26 raste, Fushë-Kosovë 23 raste, Lipjan 16 raste, Kamenicë 15 raste, Podujevë 14 raste, Deçan 12 raste, Ferizaj 12 raste, Obiliq 12 raste, Suharekë 8 raste, Drenas 7 raste, Viti 7 raste, Gjakovë 6



raste, Klinë 3 raste, Pejë 3 raste, Vushtrri 3 raste, Junik 2 raste,

Malishevë 2 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga një rast

komunat Dragash, Klokot dhe Shtime", ka njoftuar IKShPK-ja.



Vetëm gjatë pandemisë janë kryer mbi 400 mijë shërbime në Klinikën e Onkologjisë

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Në Klinikën e Onkologjisë, e cila funksionon në kuadër të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK), gjatë pandemisë janë kryer mbi 400 mijë shërbime. Kështu ka bërë me dije drejtori i kësaj klinike, Ilir Kurtishi. "Mbi 400 000 shërbime të ndryshme të Klinikës së Onkologjisë gjatë kohës së

pandemisë, punë e palodhur e stafit të Klinikës së Onkologjisë. Respekt për secilin person të klinikës, stafit mbështetës, infermierëve, fizioterapeutëve, fizikanëve, mjekëve. Faleminderit secilit prej jush!", ka shkruar ai në llogarinë e vet në "Facebook". Gjatë pandemisë janë infektuar me Covid rreth 350 pacientë të cilët vuanin nga kanceri.

Policia e Kosovës pranon pesë qen për njësinë "K9" nga UNDP-ja

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Në një ceremoni të organizuar në ambientet e drejtorisë së përgjithshme të Policisë së Kosovës, në të cilën ishin të pranishëm drejtori i policisë, Samedin Mehmeti me bashkëpunëtorë, si edhe Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, Policia e Kosovës ka marrë një donacion pesë qensh për njësinë "K9". Dorëzimi-pranimi i këtij donacioni është nënshkruar nga drejtori i

përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko. Për pjesëmarrësit është bërë një prezantim i shkurtër i qenve në veprim nga pjesëtarë të njësisë "K9". Ky donacion, sipas Mehmetit, dëshmon bashkëpunimin e fuqishëm të Policisë së Kosovës me UNDP-në. "Donacioni i sotëm ka për qëllim mbështetjen e Policisë së Kosovës në ngritjen edhe më tej

të produktivitetit policor në parandalimin e kontrabandimit, zbulimit dhe konfiskimit të armëve ilegale, municionit dhe eksplozivëve", ka thënë Mehmeti. Ndërsa përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, ka theksuar se në rrethanat të jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia, janë të sfiduar të vazhdojnë të sigurojnë shërbime për të gjithë njerëzit në mënyrën më efektive të mundshme.



Meliza Haradinaj-Stublla jep dorëheqje nga pozita e kryediplomates

PRISHTINË, 9 MARS - Pas ngritjes së dyshimeve për manipulim të votave në zgjedhjet e 14 shkurtit, Meliza Haradinaj-Stublla ka dhënë dorëheqje nga drejtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe nga funksionet në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. “Këtë vendim e marr vetëm për shkak të pamundësisë morale që më është shkaktuar dhe imazhit që më është dëmtuar nga persona me qëllime të pista, e jo sepse ndiej përgjegjësi për manipulimet dhe akuzat që më janë mveshur pamëshirshëm mua dhe familjes time. Cenimi i nderit dhe punës sime nga lojërat denigruese të të tjerëve, paraqet shkak-pasojën e këtij vendimi”, ka shkruar Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në “Facebook”.

Ajo ka drejtuar akuza në adresë të AAK-së dhe liderit Ramush Haradinaj. “Nuk është sekret që Aleanca nuk ka qenë favorite për t’i fituar zgjedhjet. Ky fakt ka alarmuar disa që mbijetesën politike e kanë luftë për ekzistencë! Ata janë angazhuar që me çdo kusht ta fitojnë betejën zgjedhore, pa zgjedhur mjet e as rrugë. Me çdo kusht kanë aderuar njerëz të padëshmuar e të panjohur për strukturat e partisë, për t’i ndërtonur projeksionet dhe aleancat e tyre për mirëmbajtjen

e kontrollit dhe shantazhit përbrenda”, ka shkruar Haradinaj-Stublla.

Dorëheqja e Haradinaj-Stubllës ka ndodhur një ditë pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i miratoi si të bazuara disa nga apelet e kandidatëve dhe subjekteve politike që morën pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Një nga apelet kishte të bënte me dyshimet për manipulim të votave me kusht dhe me postë në favor të Haradinaj-Stubllës. Po ashtu, me miratim të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) miratoi kërkesën për rinumërimin e votave të shtatë vendvotimeve të cilat janë numëruar nga persona të dyshuar për përfshirje në manipulim.

Florentina Gjergjaj, kandidate për deputete e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka fituar njërin nga betejat e saj të para që nga përfshirja në politikë. PZAP-ja ka dërguar në rinumërim të gjitha votat me kusht dhe ato me postë të AAK-së, pasi Gjergjaj pretendon se gjatë numërimit të këtyre votave kanë ndodhur parregullsi, që i kanë kushtuar asaj me humbjen e pozitës të deputetes. “Unë dhe shtabi im në vazhdimësi kemi



qenë duke e përcjellë rezultatin që nga publikimi i formularëve nga KQZ-ja. Pjesë e shtabit kanë qenë ekspertë të proceseve zgjedhore dhe ekspertë juridikë. Kemi vërejtur ndryshime në rezultate të njëres nga kandidatet e cila nuk ka qenë në përputhshmëri me numrin e votave të fituara nga subjekti. Parimisht iu besoj institucioneve dhe cilido që të jetë vendimi përfundimtar nga institucionet, do ta respektoj”, ka thënë Gjergjaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Në apelin e saj, Florentina Gjergjaj ka thënë se deri para numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë, ajo dhe kandidatja tjetër nga AAK-ja, Albana Bytyqi, kishin më shumë vota sesa kandidatja Meliza Haradinaj-Stublla. “Kandidates Meliza Haradinaj-Stublla në mënyrë artificiale i është rritur numri i votave nga personat që kanë futur të dhënat në sistem apo nga personat kompetentë të cilët kanë bërë numërimin dhe rinumërimin e votave”, është thënë në apelin e kandidates

Gjergjaj.

AAK-ja në total ka marrë rreth 3 000 vota me kusht dhe me postë, nga të cilat, sipas Gjergjajt, 709 vota kanë shkuar në favor të Meliza Haradinaj-Stublla. “Është e pabesueshme që vetëm një nga kandidatët në listën e AAK-së të ndryshojë pozicion të vazhdueshëm gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë”, shtohet në apel.

Në vendim, PZAP-ja është thirrur edhe në një video të publikuar në një portal vendor, ku shihen tre persona të cilët dyshohet se diskutojnë lidhur me falsifikimin e votave për kandidaten e AAK-së në QNR. Haradinaj-Stublla edhe më herët i kishte hedhur poshtë të pabaza këto akuza. Më 8 mars ajo kishte deklaruar se e mirëpret vendimin e PZAP-it për rinumërimin e votave, duke thënë se një veprim i tillë është “një hap përpara zbardhjes së incizimit të inskenuar që pretendon përfshirjen e bashkëshortit tim në vjedhjen e votave”.

Kreu i AAK-së, Ramush

Haradinaj, ka deklaruar se u uron “dënime meritore” të gjithë atyre që kanë manipuluar votat.

Kjo është hera e parë në Kosovë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, urdhërohet rinumërimi i votave për kandidatët për deputetë. Në QNR komisionarët që merren me procesin e numërimit janë të punësuar nga KQZ-ja, por vëzhguesit e subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare lejohen që ta monitorojnë procesin. Zyrtarët e KQZ-së nuk komentojnë se a ka lëshime që mund të çojnë në manipulim të rezultatit, por thonë se ky institucion e ka ftuar prokurorinë që t’i hetojë pretendimet e ngritura. “Pas publikimit në media të lajmit, KQZ-ja ka reaguar menjëherë, duke kontaktuar me Prokurorinë e Shtetit. Si KQZ, kemi ofruar të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme për hetimin dhe zbardhjen e plotë të rastit”, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë”, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.



Besnik Tahiri emërohet ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, ka emëruar zëvendëskryeministrin e parë në detyrë, Besnik Tahiri, ministër në detyrë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Emërimi i Tahirit vjen pas dorëheqjes së Meliza Haradinaj-Stubllës nga kjo pozitë.

Haradinaj takon ambasadorin e Maqedonisë, flasin për zhvillimet në Kosovë

PRISHTINË, 9 MARS - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, Shpresa Jusufi, me të cilën kanë diskutuar për zhvillimet në vend dhe për nevojën e krijimit të institucioneve të reja. Në

profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se Kosova dhe Maqedonia e Veriut janë bërë shembull i fqinjësisë së mirë dhe aleate në rrugën e përbashkët euroatlantike. “Kënaqësi të prisja sot në takim ambasadorin e Maqedonisë së Veriut në Kosovë, znj. Shpresa Jusufi. Duke e falënderuar për angazhimin e

saj, me ambasadorin diskutuam për zhvillimet në vend, nevojën e krijimit të institucioneve të reja dhe thellimin e bashkëpunimit në të mes dy vendeve. Kosova dhe Maqedonia e Veriut janë bërë shembull i fqinjësisë së mirë dhe aleate në rrugën e përbashkët euroatlantike”, ka shkruar Haradinaj.



Ndalohej një automjet me 435 kilogramë duhan të kontrabanduar

PRISHTINË, 9 MARS (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka ndaluar të martën një automjet i cili po transportonte 435 kilogramë duhan të kontrabanduar. Sipas

doganës, tentimi i kontrabandës në fjalë do t'i shkaktonte shmangie taksës së akcizës rreth 15 mijë euro. "Njësitet e Doganës së Kosovës kanë arritur të identifikojnë

dhe ndalojnë një automjet i cili ishte duke transportuar 435 kg duhan të grirë, respektivisht gjatë kontrabandimit. Tentimkontrabanda do të shkaktonte shmangie të taksës

së akcizës rreth 15 000 euro. Sektori përkatës i doganës ka vazhduar procedurat në bashkëpunim me prokurorinë", ka njoftuar Dogana e Kosovës.



Gërxfhaliu: Procesi i privatizimit, sfidë për qeverinë e ardhshme



PRISHTINË, 9 MARS - Kosova ka 99 prona të ndërmarrjeve shoqërore që gjenden në Serbi, 35 prona në Mal të Zi, 15 prona në Bosnjë Hercegovinë, tetë asete në Maqedoninë e Veriut, pesë në Kroaci dhe një pronë në Slloveni. Sipas të dhënave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), asetet jashtë Kosovës janë të ndërmarrjeve: "Trepça", "Kosova Sirovina", "Jugoterm", "Bankos", "Anamorava", "Komuna", "Farmakos", "Artizani", "NSH Komuna", "Kosova Vera", "18 Nëntori", "IGK Ballkan", Fabrika e Birrës "Peja", "Jatex", Fabrika e Lëkurëkëpucëve "Modeli", "NT

Rugova" "Kosovashped", "Tursit Kosova", "Progres printing", "IFS Progres", "Filgran", "Amortizatorët", "EUP Ingernering", "Agrokosova", "Mekanizimi", "Integj" etj. Me këtë rast, eksperti i ekonomisë, Safet Gërxfhaliu, ka vlerësuar se procesi i privatizimit është përcjellë me jotransparencë dhe keqpërdorime, qoftë nga aktorë vendorë dhe ndërkombëtarë, nga i cili proces ka pësuar ekonomia e Kosovës, në veçanti është rënduar aspekti social në Kosovë dhe, mbi të gjitha, është dëmtuar imazhi i vendit. "Të shiten 845 ndërmarrje shoqërore dhe publike për 670 milionë euro

dhe 30 000 hektarë të tokës bujqësore për 99 milionë euro ose 3 300 euro për një hektar, të humbin punën më shumë se 80 000 punëtorë, shkak i privatizimit, është procesi më rrënues i ekonomisë së Kosovës", ka thënë ai, raporton RTK. Sipas Gërxfhaliut, mungesa e sundimit të rendit dhe ligjit dhe e llogaridhënies ka dëmtuar këtë proces e në veçanti, spinoofin special dhe tjetërsimin e pasurisë së Kosovës jashtë vendit. "Prandaj qeveria e ardhshme duhet të merret me seriozitet me këtë problematikë dhe të mos i lihet kohës", është shprehur Gërxfhaliu.

Qeveria merr vendim për shpronësimin e disa tokave për autostrada

PRISHTINË, 9 MARS - Qeveria në detyrë e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të martën, ka miratuar vendimin për shpronësimin e disa pronave të paluajtshme. Është marrë vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme ish-shoqërore për realizimin e projekteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). "Në mbledhjen e sotme është miratuar vendimi për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për: Ndërtimi i objektit të ri të Gjykatës Themelore në Pejë, Komuna Pejë. Ndërtimi i objektit të ri të Gjykatës Themelore në Prizren, Komuna Prizren. Renovimi dhe ndërtimi i ish-objektit të filialit të 'Jugobankës' në Mitrovicë, për nevojë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Komuna Mitrovicë", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Po ashtu, është miratuar edhe vendimi për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim të pronave të paluajtshme për ndërtimin e autostradës së Prishtinës - Gjilan - Dheu i Bardhë. "Në zonën kadastrale Bresallc, Komuna Gjilan, e cila preket nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë; në Zonën Kadastrale Balincë, Komuna e Malishevës, e cila preket nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N9, Prishtinë - Pejë dhe; në zonën kadastrale Milloshevë, Komuna e Obiliqit, e cila preket nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë. Në vazhdim të mbledhjes, kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të vendimit përfundimtar nr. 12/71, datë 23.10.2018, me të cilin janë miratuar shpronësimet e pronave të cilat preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Gjilan -



Dheu i Bardhë, segmenti Banullë - Bresallc, që prek komunat Lipjan (zonat kadastrale Banullë, Slovi, Smallushë), Novobërdë (zona kadastrale, Parallovë) dhe Gjilan (zonat kadastrale Bresallc, Ponesh dhe Zhegovc)", ka njoftuar qeveria

e drejtuar nga kryeministri në detyrë, Avduallah Hoti. Më tutje, qeveria ka miratuar vendimin përfundimtar për shpronësimin për interes publik të objekteve të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), të

cilat preken nga realizimi i projekteve: ndërtimi i Parkut që do të shërbejë për amfiteatrin e fshatit Mushtisht dhe ndërtimi i "Çerdhës së fëmijëve dhe këndi për të moshuarit" në fshatin Studençan, Komuna e Suharekës.

"Bitcoin" sërish i rikthehet fitimeve, rritet 10 për qind brenda një jave

UASHINGTON, 9 MARS - Pas një rënie të theksuar, "Bitcoin" sërish iu është rikthyer fitimeve. Sipas "CoinMarketCap", aktualisht kjo kriptovalutë po tregtohet me rreth 54 mijë dollarë. Në fund të muajit shkurt "Bitcoin" kishte arritur në vlerën e 58 354 dollarëve derisa

një javë më vonë ishte zhvlerësuar me 15 mijë dollarë. Javë më parë, "Tesla" kishte blerë 1.5 miliardë dollarë në vlerë të "Bitcoinit", duke thënë se së shpejti do të pranonte pagesa në këtë monedhë. Kurse sekretarja amerikane e Thesarit, Janet Yellen, ka lëshuar një paralajmërim në

lidhje me rreziqet që paraqet "Bitcoin" për investitorët dhe për publikun. Sipas Yellen, mbetet pikëpyetje në lidhje me legjitimitetin dhe stabilitetin e kriptovalutës. Aktualisht vlera e tregut të kriptovalutave është 1.65 trilionë dollarë, ndërsa "Bitcoin" përbën mbi 60 për qind të tregut.



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (2)

Demonstratat e vitit 1981



Shkruan: Bedri ISLAMI

Ali Ahmetin unë e kam njohur fillimisht me emrin "Abaz", pastaj si "Abaz Gjuka", më tej me emrin Ali Ahmeti. Ka qenë e natyrshme për kohën. Në ndjenjat e gjata, sidomos pasi të dy u zgjodhën në udhëheqjen e Lëvizjes, aq sa kemi folur për luftën aq e, ndoshta më tepër, flisnim për librat, filozofinë dhe historinë. Ne ishim dy miq të cilët kishim kaluar shumë vite në të njëjtën rrugë dhe, si i thonë, kishim ngrënë shumë bukë bashkë. Ali Ahmeti është përgjithësisht njeri i qetë, i pabujë, për të cilin kam shkruar se "gjithë jetën kërkoi luftën dhe, kur e gjeti atë, zgjodhi paqen".

Nuk e kisha menduar se atë bisedë, të cilën e regjistrua për një libër tjetër, do e risillja. Viti 1981 shënon fillimet e përfshirjes së tij në Lëvizjen Kombëtare, që më pas u quajt Lëvizja Popullore e Kosovës e ku u përfshimë të dy.

Duhet kuptuar se kjo është një bisedë mes dy miqve. Po shkëpus vetëm një pjesë të saj, e cila lidhet pikërisht me temën e mësipërme.

Unë: - Ka edhe një dukuri tjetër, po ashtu, shumë e veçantë. Mund të jetë një nga tiparet më përdalluese të lëvizjes klandestine çlirimtare: përfshirja në të, jo vetëm e një pjesëtari të një familje, por e të gjithë saj, të gjithë vëllezërit, motrat, prindërit e të afërmit. Kjo nuk ka të bëjë me idenë e fisit, është shumë larg saj. Më tepër se gjithçka, mund të përmblihet në fjalët se, shpirti i tokës kalon tek njerëzit. Virtuti i vërtetë është i pavetëdijshëm, dhe ne, mund të them lirisht, jemi një popull që nuk na tremb lartësia, por përkulja. Dhe nëse një njeri i yni përkulet, këtë e kemi ndjerë të gjithë. Çfarë duhet bërë aty ku mbaron shteti? Aty ekziston populli. Kemi kështu disa familje në Kosovë, rreth të cilave populli ka gjetur veten. Me emër, të cilat, dashje pa dashje, janë kthyer në shëmbëlltyrë. Janë të njohura tashmë familje të tilla si Jasharët, Haradinajt, Gërvallët, Lladrovçët, Kiçinët, Krasniqët, Selimët, Kelmendët, Xhemajlët, Lushtakët, Kodralinjët, Ajetët, e Pajazitët. Të gjitha ngajnë si dinasti të luftës. Mirëpo, vëllazërohen edhe njerëz që nuk kanë lidhje gjaku, bëhen një familje. Më the se Fehmi Lladrovçin e ke njohur edhe në rrugë familjare...

Abazi (Ali Ahmeti): - Të gjithë ne, bacalok, si veprimtarë, disa

jemi gjallë, pjesa më e madhe kanë rënë nëpër fronte, na ka njohur situata e vitit 1981, me shpërthimin e protestave. Ajo edhe na ka bashkuar. Aty janë edhe rrënjët e lidhjeve që u krijuan dhe i qëndruan moteve.

Demonstratat e vitit 1981 janë udhëhequr nga grupe të shumta, nuk kishte një qendër të vetme, që të vepron në mënyrë të prerë, të centralizuar. Inspirohej nga gazetatat, si për shembull "Bashkimi", "Liria", "Lajmëtari i Lirisë", "Zëri i Kosovës". Nuk na interesonte se kush i nxirrte, për ne, të gjitha kanë qenë njësoj. Gazetat kanë qarkulluar tek të gjithë studentët. Futeshin gazetatat në palë të librave deri në Bibliotekën Kombëtare, i shpërndanim në konviktet e studentëve. Periudha e vitit 1981 na lidhi në disa rrethe. Me njerëz që nuk i kishim njohur më parë u bëmë vëllezër. Vetë koha ishte e tillë. Në këto grupe ka pasur edhe njerëz të UDB-së, që na i kishte infiltruar. UDB-ja e ka ditur se ne po organizohemi, se diçka po lëviz, por ka qenë e pamundur të ndërpritej vullneti i studentëve për Republikën e Kosovës.

Dikush mendon se lëvizjet kanë qenë thjesht spontane. Ka pasur edhe lëvizje spontane, por, më së shumti, kanë qenë të organizuara. Për shembull, miku ynë i përbashkët, Xhevat

Zeka ka qenë i pari që në mensë, me arsyen e rreme se kërkohet ushqim më i mirë, ka filluar të protestojë. Ishte ora gjashtë e mbrëmjes e datës 11 mars, fillimisht jemi kapë për ushqime. Është bërë rrëmujë brenda mensës. Për një minutë, gjithçka ishte e përmbytur. Për një moment i gjithë kati i parë dhe i dytë kemi qenë përjashta. Fillimisht protestuam: "Duam kushte, ushqim më të mirë". Pastaj kemi dalë në rrugët e Prishtinës. Kur kemi mbërrit para shtëpisë së Xhavit Nimanit, që asokohe ka qenë funksionar i lartë, atje kemi filluar të protestojmë, "Duam Shtet". Kur kemi hyrë në qendër të Prishtinës, zëri është ngritur më e tashmë parulla ishte: "Kosova punon, Beogradi ndërton". U grumbulluan edhe njerëz të tjerë, jo studentë. Dolën punëtorë e familjarë, masa u bë e madhe dhe filluam me parulla politike, "Të drejtat duam" e "Duam barazi". Marshuam një orë, na shpërndau policia, filluan fjalimet, erdhën profesorët, kërkohet të rrinim urtë. Ne u thoshim se, në Kosovë, ka filluar prej kohe diskriminimi, se nuk ka racizëm vetëm në Afrikën e Jugut, por edhe në Prishtinë. Hipi Pajazit Nushi në tribunë të mbajë fjalim. E gjuajtëm me gurë, sepse nuk e njihnim se kush është. Pajaziti nuk kishte qëllim të keq. E

kisha profesor dhe kisha respekt për të. Krejt nata e 11 marsit ishte me debate, me fjalime, por, pasi përfunduam debatet, na shpërndanë me dhunë, duke përdorur gazin lotsjellës. Nuk e dinim se çka ishte, menduam se na vranë të gjithëve.

Prej datës 11 deri më 26 mars kemi mbledhë forcat në vete. Analizuam se çfarë ishte, e u mësua edhe me gazin lotsjellës. Më 26 u mblodhëm përsëri para konvikteve. Erdhi Azem Vllasi dhe Rektori i Universitetit të asaj kohe. Azem Vllasi ishte i ashpër, cinik, denigrues. Aty ka dalë kërkesa "Kosova Republikë". E theksoi për herë të parë haptas Gazmend Zajmi. Rektori Zajmi tha se si kërkesë ishte e mirë, por duhen parë hapat dhe koha. Kështu ai na nxiti që të ishim më të vendosur. Më vonë, kam marrë vesh se çështja e republikës ishte diskutuar mes Gazmendit dhe Ukshin Hotit. Ukshini kishte qenë për shumë vite Sekretar për Marrëdhëniet me Jashtë i Kosovës, që i binte si rang ministri të jashtëm të Kosovës. Kur dëgjuam rektorin, atëherë filluam edhe një herë: "Duam Republikë". Erdhi duke u shtuar dhe dikush thirri: "Republikë, Kushtetutë - ja me hatër - ja me luftë".

Po atë ditë, më 26 mars, vinte edhe 'Stafeta e Titos'. Kështu quhej. Bëmë sikur nuk e dimë.



Një grup shokësh shkoi tek stafeta, me e prishë atë. Të gjitha organizimet ato ditë bëheshin legale, gjithkush e dinte se ku do të shkojmë dhe si do të veprojmë. Ishte si valët e detit, nuk mund t'i ndalje. Na gjuajtën me gaz lotsjellës. Një pjesë na mbyllën në konvikte. Jemi nisë për të dalë në qytet, me i ardhë në ndihmë atyre që ishin caktuar me prishë 'stafetën e Titos'. Një pjesë kemi mbet në konvikte, na kanë rrethuar. Ne protestonim. Atëherë policia u fut brenda dhe na kanë futë dajak edhe brenda në konvikte. Erdhi sekretari i punëve të brendshme, Mehmet Maliqi, baba i Shkëlzen Maliqit. Filloi edhe ai: "Ju jeni djem të rinj, ju kanë rrejt, jeni të mashtruar". Na u dha hapësira për më 1 prill e 2 prill. Jemi burgosë një grup shokësh, organizatorë, të

nisin përjetimet, që disa herë janë përvëluese; ata, përgjithësisht, nuk i njohin rrugët e sheshta dhe të shtruara, në çdo rast ata çajnë përmes dhimbjes drejt pakufisë. Gjithsecili, i marrë veçmas, ndien njëllë, se duhet të jetë ndërtues i një vlere të re e të papërshkueshme. Është një brez kurajoz dhe kurioz në të njëjtën kohë, të gjithë së bashku janë të gatshëm të jenë martirë dhe profetë njëkohësisht. Që këndeje lindin miqësi të mëdha, të cilat i rezistojnë kohës, edhe kur ajo rrjedh furishëm, dhe pambarimisht është e mbushur me enigmën e së ardhmes.

Abazi (Ali Ahmeti): - Lidhjet e mia me Fehmiun në veçanti, edhe me shokët e Drenicës në përgjithësi, nuk kanë qenë asnjëherë kalimtare. Kjo është

Shqipërinë? Abazi (Ali Ahmeti): - Sigurisht. Nuk kishte rrugë tjetër. Ne, të jem i sinqertë, lëvozhgën e kishim marksiste, thelbin e kishim nacionalist. Në vitin 1981, shpresën e kishim në shtetin nanë. Deri sa foli Tirana e kishim zemrën e ngrirë. Ka pasur shokë që kishin lidhje më të drejt për drejta. Sidomos shkalla e lartë e organizimit.

Viti 1981 mbetet vit themeltar. Atij nuk mund t'i shmangemi dhe mund të shpëtojmë prej tij, edhe sikur të duam. Nuk mund t'i shmangemi as dritës që hodhi ai dhe as hijeve që janë, po ashtu, të pashmangshme, si ndodh me të gjitha ngjarjet e mëdha. Sepse kur ngjarjet, që janë përherë në lëvizje, na shtrojnë një pyetje, ajo pjesë e historisë hulumtuese, që është e saktë, e patundshme, kërkon edhe përgjigjen e saj. "Përmbi absoluten revolucionare, është absolutja njerëzore", shkruan Viktor Hygo, dhe në vitin 1981 njerëzorja kishte fituar mbi antinjerëzoren.

Është, si të thuash, ndeshja e përhershme e vizionit ndaj dhunës, e së mirës ndaj së keqes, e të përhershmes ndaj përkohshmërisë.

Ishte fillesa, por jo përfundimi. Në vitin 1981 të gjithë e ndjenin veten zotër, por ishin gati të bëheshin martirë. Kishte dishepuj të lirisë, por koha kërkonte që të bëheshin prijës. Ishte një ngjarje e madhërishtme dhe kryengritje e fisme, por si të gjitha lavditë, në vitet e mëpasshme, shkaktoi furi të madhe, zhurmë marramendëse dhe re pluhuri. Është vit i paasgjësueshëm.

Në një intervistë dhënë në burg gazetës "Borba" të datës 24 mars 1989, Adem Demaçi ka thënë: Kryengritja e vitit 1981, po them kryengritje, sepse ajo njëmend ishte e tillë, ka dëshmuar se Lëvizja jonë funksionon sipas principit të



miellit dhe ujit. Veprimet e pamenduara të burokracisë nacionale dhe të policisë shtojnë protestat, aktorët e të cilave burgosen, kështu që të tjerët kërkojnë lirim të tyre dhe kështu me radhë. Mielli dhe uji kthehen në brumë që rritet, dhe mendojini me mijëra të rinj që kanë kaluar nëpër burgje, se cili është përcaktimi i tyre.

Në vitin 1981 në Kosovë ndodhi një kryengritje që zgjoi gjithçka dhe fundosi mitin e shtetit shumëkombësh jugosllav. Të gjithë donin të ishin në radhët e para.

Në Prishtinën zyrtare mendonin se e keqja u kishte ardhur nga Shqipëria. Ose donin të mendonin kështu. Që kishte pasur një përplasje, kjo është e vërtetë; që secili kishte përdorur armët e veta dhe

njerëzit që kishte menduar si të duhurit, edhe kjo ishte e vërtetë. Më shumë se gjithçka dukej si një përplasje akullnajash, por sa kishte qenë e vërtetë?

Aty ku digjen librat, në fund digjen edhe njerëzit /
Heinrich Heine

Pas turbullimit të parë dhe ngulosjes, në Komitetin Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës mbizotëronte mendimi se kishte ngjarë një tentim kundërrevolucionari, që synonte ta përmbyste me dhunë rendin shoqëror, se ngjarjet e vitit 1981 kishin qenë të organizuara, të iniciuara nga Tirana, ku lëvizja studentore dhe Instituti Albanologjik ishin qendra e tyre.

(VIJON)



tjerët kanë vazhduar.

Kjo është periudha që na ka njohur me të gjitha trevat. Deri atëherë kishte një farë ndarjeje, ishim më shumë lokalë. Mirëpo, pas demonstratave, nuk kishte më, 'unë jam i kësaj ane e ti je i anës tjetër'.

Në këtë kohë jam njohur edhe me Fehmiun, si rezultat i demonstratave të vitit 1981. Dhe kemi filluar edhe lidhjet familjare. Që nga viti 1982, bacalok, nuk jemi ndarë më. Mund të kalonte një kohë që nuk takoheshim, por lidhjet i mbanim; lidhjet me njëri tjetrin vazhdonin. Unë e dija vendin tim në shtëpinë e Lladrocvë. Ishte shtëpia ime, prindërit e tij ishin edhe të mitë. Për herë të fundit kam folur me të dy ditë para se të vritej. Ishte në malet e Çiçavicës, ndërsa unë isha në Zvicër. Të nesërmen e bisedës kam udhëtuar për në Tiranë, ku kam mësuar lajmin e vrasjes së tij dhe të Xhevës. Pastaj, ti e di, të mora në telefon dhe të tregova.


Unë: - Ngjarjet e vitit 1981, në një mënyrë ose në një tjetër, janë gurthemeli i shumëçkaje që do të vijë më vonë në historinë e Kosovës. Veç një gjë nuk ka se si të mos bëjë përshtypje: duke qenë njerëz të fillimit të ri, përgjithësisht studentë, në secilin nga këto idealistë, lind bota; çështjet deri atëherë kanë formë të ngurtësuar, befasi ata fillojnë të ziejnë në gjakun e tyre dhe

meritë e vitit 1981. Hapësira e Lëvizjes Kombëtare u shtri në të gjithë trevat dhe nuk mund të arrihej pa besim. Kur ti, bacalok, u zgjodhe kryetar i kësaj Lëvizjeje, pra i Lëvizjes Popullore të Kosovës, e ke parë se në shumë raste shokët, kur duan të saktësojnë diçka si të palëkundshme thonë, ai është i vitit 1981. Pra, si shenjë prove të dhënë. E gjithë kryesia e Organizatës dhe thuajse të gjithë drejtuesit e lartë të UÇK-së e kanë fillësën në vitin 1981 e në vitin 1989.

Unë: - E Shqipëria? Kur u ngritët në mars 1981, ashtu si ndodhi, e menduat



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sot zhvillohen tri ndeshje në Superligë, dy nesër



PRISHTINË, 9 MARS (ER) - FC Prishtina e kërkon fitoren e radhës në ndeshjen kundër rivalit të vjetër Besës së Pejës. Kryeqytetasit kanë shënuar dy fitore në këtë edicion kundër Besës me rezultat 4-0 dhe 0-2, por sivjet rivaliteti mes këtyre dy skuadrave nuk është sikurse në të kaluarën për faktin se prishtinasit po luftojnë për titull dhe pejanët do të bien në Ligën e Parë. Sot zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Llapit dhe Drenicës, skuadra që janë në garë për mbijetesë. Llapi në ndeshjen e fundit pësoi humbje nga Prishtina, derisa kuqezinjët pësuan humbje nga Ballkani. Ndeshja e tretë për ditën e sotme do të zhvillohet në stadiumin "Riza Lushta" në mes të Trepçës '89 dhe Feronikelit. Edhe këto dy klube

kërkojnë pikët maksimale në mënyrë që të ikin nga zona e rrezikshme. "Nikli" pësoi humbje në minutat shtesë në ndeshjen ndaj Dritës, kurse 89-shi i mori pikët maksimale në përballje me Besën në Pejë. Nesër (e enjte) zhvillohet derbi i xhiros në mes të Dritës dhe Gjilanit. Rivaliteti i dy skuadrave gjilanasë është i madh dhe vlerësohet si derbi më i madh në futbollin e Kosovës. Drita edhe në këtë edicion ka formë më të mirë, sepse është në vendin e parë dhe synon mbrojtjen e titullit. Në anën tjetër Gjilani, edhe përkundër investimeve dhe ndryshimeve në shtabin teknik, është jashtë garës për titull dhe Kupë. Të mërkurën zhvillohet edhe ndeshja në mes të Arbërisë dhe Ballkanit.

SUPERLIGA - Java e 24-t

Të mërkurën takohen:
13:00 Trepça'89 - Feronikeli
13:00 Llapi - Drenica
13:00 Prishtina - Besa

Të enjten takohen:
13:00 Drita - Gjilani
13:00 Arbëria - Ballkani

LIGA E PARË - Java e 18

GRUPI A

Të mërkurën takohen:
13:00 Liria - Malisheva
13:00 Vëllaznimi - Trepça
13:00 Vushtrria - Dukagjini
13:00 Istogu - A&N
13:00 Drenasi - Onix

GRUPI B

Të mërkurën takohen:
13:00 Ferizaj - Vitia
13:00 Ramiz Sadiku - 2 Korriku
13:00 Flamurtari - Ulpiana
13:00 Dardana - KEK-u
13:00 Vllaznia (P) - Kika

SHKURT

Aliti nënshkruan kontratë me Zurichin

Ekipi zviceran, Zurich, e ka shfrytëzuar opsionin për ta blerë qendërmbrojtësin nga Kosova, Fidan Aliti. Aliti ishte te Zurichu në formë huazimi nga ekipi suedez Kalmar, ndërsa i ka bindur zviceranët që t'i ofrojnë kontratë të përhershme. Ai prej vitit 2019 ishte pjesë e Kalmarit, ekip në të cilin kaloi nga Skënderbeu. Fidan Aliti do të jetë pjesë e Zurichut deri në vitin 2023. Aliti është shtylla e mbrojtjes e ekipit të Kosovës së bashku me Amir Rrahmanin.

Thaqi: Presim fitore edhe ndaj Arbërisë

Futbollisti Armend Thaqi ka shprehur optimizëm se skuadra e Ballkanit do të arrijë të marrë fitore edhe në ndeshjen ndaj Arbërisë. "Jemi përgatitur maksimalisht për ndeshjen e radhës. Fitorja ndaj Drenicës ka dhënë qetësi për ndeshjen e radhës. Objektivi ynë normalisht se është fitorja, pasi vetëm në këtë mënyrë do të jemi në hap për të arritur cakun që kemi si klub. Ndeshja do të jetë e vështirë, pasi edhe skuadrës së Arbërisë i duhen pikët, por ne nuk kemi rrugëdalje tjetër. Së bashku me angazhimin e bashkëlojtarëve shpresojmë ta arrijmë synimin që kemi para vetes", ka thënë Thaqi për "Gazeta Sheshi".

Wilder: Kam 99 probleme e halle, por jam ende mbret dhe i pasur

Boksieri amerikan Deontay Wilder nuk duelon që prej shkurtit të vitit të kaluar, kur humbi titullin kampion bote në peshën e rëndë (WBC) ndaj Tyson Furyt, humbje që ka shkatërruar disi psikologjikisht e moralisht "Bronze Bomber", që ende nuk ka vendosur nëse do të rikthehet në ring. Gjithsesi, përmes një postimi në rrjetet sociale ai konfirmon se është i lumtur dhe se po shijon 30 milionë dollarë që ka bërë gjatë karrierës së tij (42 tore, 1 humbje, 1 barazim). I ulur në kolltuk, me një shishe verë përpara, ai komenton në rrjetet sociale. "Kam 99 probleme e halle, por jam ende mbret dhe i pasur", shprehet Deontay Wilder, tashmë 35-vjeçar. Kohët e fundit është përfolur se ai mund të duelojë ndaj Andy Ruiz Jr., Dillian Whyte, Alexander Povetkin, Oleksandr Usyk etj., por asgjë nuk ka konkrete.

Kosova luan për fitore ndaj Rumanisë

PRISHTINË, 9 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll sonte (e mërkurë) do të takohet me Rumaninë. Shtabi teknik, në krye me selektorin Bujar Qerimi, është i kënaqur me punën që kanë bërë lojtarët për këtë ndeshje, kurse hendbollistët i kanë vlerësuar të suksesshme përgatitjet,

pavarësisht prej disa telasheve të vogla me lëndime. Ndeshja e fazës së dytë kualifikuese për "Euro 2022" në mes të Kosovës e Rumanisë luhet të mërkurën nga ora 19:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. "Gjithmonë luajmë për fitore, edhe pse përballë kemi një

kundërshtar të fortë si Rumania. Kemi punuar mirë, kemi luajtur me rumunët dhe kjo na ndihmon për të përgatitur më mirë ndeshjen. Shpresojmë të paraqitemi me dinjitet ndaj Rumanisë. Të gjithë jemi të përkushtuar për të dhënë më të mirën", ka thënë portieri i Kosovës, Haris Berisha.



U mbajt trajnimi i parë online për sistemin VAR

Prishtinë, 9 mars - Ekipi i projektit VAR në Federatën e Futbollit të Kosovës është duke punuar me intensitet në procesin e implementimit të tij. Puna në këtë projekt ka nisur në fillim të muajit janar nën mbikëqyrjen e përgjegjësit Albert Bunjaku, derisa tashmë është duke u

punuar në tri fusha: në çështje administrative, në çështje edukative-teknike dhe në çështje të infrastrukturës. “Është mbajtur trajnimi i parë online me gjyqtarët e Superligës dhe operatorët e sistemit VAR. Në këtë trajnim ka ligjruar instruktori i FIFA-s për VAR,

Valentin Ivanov. Pas këtij trajnimi do të fillojë edhe pjesa praktike, e cila do të mbahet në Tiranë, në bashkëpunim me FShF-në. Faza e edukimit do të jetë e kombinuar me trajnime online dhe ato fizike dhe ky proces do të zgjasë 6 deri në 9 muaj”, thuhet në njoftimin e FFK-së.



Barça shpreson në një tjetër 'La Remontada'

PARIS, 9 MARS - Duke synuar “La Remontada” në edicionin 2016-’17, Barcelona udhëton në “Parc des Princes”, duke shpresuar ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë 1-4 në Ligën e Kampionëve kundër Paris Saint-Germain. Lionel Messi shënoi gol nga penalltia në “Camp Nou” para se të shënojë tre gola Kylian Mbappe dhe një tjetër gol e shtoi Moise Kean. Të dy gjigantët shijuan fitore në fundjavë, Barcelona e mposhti Osasuna 2-0 në La Liga, ndërsa PSG-ja e mposhti Brest 3-0 në Kupë të Francës. “Do të jetë shumë e komplikuar për shkak të rezultati të ndeshjes së parë. Ne luajmë kundër PSG-së, jo kundër një ekipi dosido. Duhet një ndeshje e përkryer. Varet shumë nga vetja jonë. Është gjithmonë ndryshe të kesh një rezultat si ai ndaj Sevillas sesa një 1-4. Është misioni i komplikuar në Paris, por asgjë e pamundur. Ne e dimë që jemi Barça”, ka thënë trajneri



Ronald Koeman, trajner i Barcelonës. PSG-ja për këtë ndeshje ka vetëm dy mungesa: Moise Kean dhe Juan Bernat, derisa Neymar është rikthyer në stërvitje dhe i mbetet trajnerit Pochettino të vendosë nëse do ta aktivizojë brazilianin. Për Barcelonën nuk do të jenë të gatshëm Gerard Pique, Sergi Roberto, Ronald Araujo, Ansu Fati dhe Philippe Coutinho. Sonte nga ora 21:00 zhvillohet edhe ndeshja

tjetër në mes të Liverpoolit dhe RasenBallSport Leipzig. “Reds” e fitoi ndeshjen e parë në Gjermani me rezultat 0-2 dhe tash e ka me të lehtë kualifikimin në çerekfinale, por Leipzig do të mundohet që të bëjë befasi dhe ta arrijë përmbysjen e madhe.

TË MËRKURËN TAKOHEN:

21:00 PSG - Barcelona (4-1)
21:00 Liverpool - RasenBallSport Leipzig (2-0)

Paraqitje e suksesshme e skitarëve në garën ndërkombëtare 'Dardania Cup'

PRISHTINË, 9 MARS - Federata Skitare e Kosovës organizoi të dielën edicionin e dytë të garës ndërkombëtare “Dardania Cup”, e cila u mbajt në Qendrën Skitare “Arxhena”, në Brod të Dragashit. Pjesëmarrës ishin 45 garues të shteteve: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Greqi, Sllovakia, Turqi dhe Hungari. Garat u mbajtën në të dyja konkurrencat për grupmoshat U-14 dhe U16 në disiplinat e sllallomit dhe sllallomit të madh. Nga garueset e Kosovës veçohet Lirika Deva dhe Elena Hoxha, të cilat fituan medaljen e artë përkatësisht të bronzit, në grupmoshën U-16, disiplina e sllallomit të madh. Në konkurrencën e meshkujve, grupmosha U16, disiplina e sllallomit, Klos Vokshi, fitoi medaljen e bronzit. Të bronzit



e fitoi edhe Klara Sefaj në grupmoshën U-14, sllallom të madh. I pranishëm në garë ishte edhe nënpresidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK),

Gazmend Maxhuni, ndërsa KOK ndihmoi organizimin e garës me dhënie në shfrytëzim të një kombi nga sponsori ynë, Toyota Kosova.

SHKURT

Gjermania konfirmon largimin e Lowit pas Evropianit 2020

Trajneri Joachim Low do të largohet nga Kombëtarja e Gjermanisë pasi të përfundojë Evropiani 2020. Këtë e ka konfirmuar vetë kombëtarja gjermane përmes një komunikate zyrtare në “Twitter”. “Joachim Low do të largohet nga detyra si kryetrajner pas ‘Euro 2020’”, shkruhet në komunikatë. Lowi me kombëtaren e Gjermanisë ka arritur suksese të shumta. Më e larta ishte trofeu i Kupës së Botës në vitin 2014.

City ofron 100 milionë euro për Lukakun

Manchester City nuk po e ka ndërmend të heqë dorë nga transferimi i sulmuesit të Interit, Romelu Lukaku, këtë verë. Mediumet angleze kanë raportuar të martën se drejtuesit e Cityt janë të gatshëm të ofrojnë dëmshpërblim deri në 100 milionë euro për ta bindur Interin në lirim të Lukakut, i cili po shkëlqen këtë sezon me fanellën e ekipit italian. Te City po e shohin Lukakun si pasardhës të denjë të Sergio Agueros, i cili pritet të largohet në fund të sezonit kur edhe i skadon kontrata. Sulmuesi belg ka shënuar 24 gola dhe ka bërë shtatë asistime këtë sezon në 33 ndeshje në të gjitha garat për Interin. Lukaku iu bashkua Interit për 75 milionë euro në vitin 2019 nga Manchester Unitedi. Ai me ekipin nga Seria A ka kontratë deri në vitin 2024.

Inzaghi, në ‘radar’ të Joves dhe Interit

Simone Inzaghi është një nga trajnerët më të mirë italianë. 44-vjeçari qëndron në stolin e Lazios prej korrikut të vitit 2016 dhe ka bërë një punë të shkëlqyer tek ekipi bardhekaltër. Futboll i bukur, rritje dhe përmirësim i lojtarëve të caktuar, dhe tre trofe të fituar: një Kupë Itale dhe dy Superkupa të Italisë. “Calciomercato” raporton se ish-sulmuesi nuk do ta rinovojë kontratën e tij me Lazio. Dy klube të mëdha po e monitorojnë me kujdes situatën e Inzaghit dhe janë gati të përfitojnë. Bëhet fjalë për Juventusin dhe Interin.

Milani i ofron kontratë të re Kessies

Performanca e Franck Kessie ka bindur Milanin t’i besojë atij edhe për të ardhmen. Sipas mediave italiane, drejtuesit e kuqezinjve kanë kohë që po punojnë për rinovimin e kontratës me mesfushorin. Kontrata e 24-vjeçarit skadon në vitin 2024 dhe drejtuesit Maldini dhe Massara janë gati t’i paraqesin lojtarit rinovimin deri në vitin 2026 me një rritje page deri në 3 milionë euro. Aktualisht Kessie përfiton një pagë 2.2 milionë në sezon.

Basketbollistët në NBA refuzojnë të vaksinohen

Vaksinimi i basketbollistëve të NBA-së pritet të kthehet në një çështje të ndërlikuar javët në vijim. Pas miratimit të vaksinës “Johnson & Johnson” dhe deklaratës së presidentit amerikan Joe Biden, se

brenda majit do të ketë një mbulim të të gjithë popullsisë, pritet që nga kjo situatë të përfitojë edhe NBA. Pritet që para përfundimit të sezonit të rregullt të vaksinohen edhe lojtarët, por

duket se jo të gjithë janë dakord me këtë procedurë. NBA është përpjekur që të angazhojë në këtë fushatë disa nga yjet e saj por, pa shumë sukses. “Unë besoj se shumica e lojtarëve do të

vaksinohen. Vaksinimi është një vendim personal, jo i detyrueshëm, por jam i bindur se basketbollistët do ta kuptojnë se do të jetë në interesin e tyre ta bëjnë këtë gjë”, ka thënë Adam

Silver, komisionar i NBA-së. LeBron James, Chris Paul, James Harden dhe disa të tjerë kanë deklaruar se nuk kanë vendosur për vaksinën, duke thënë se për kryerjen e saj do të presin.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 507/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
 Suzana.goranci@rks-gov.net
 Telefon: + 381 38 200 32 553



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
 për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 506/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:


Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
 Suzana.goranci@rks-gov.net
 Telefon: + 381 38 200 32 553



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Center for Global Reporting* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.



Daut Dauti

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë

4⁹⁹ €





Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:328/1
 Dt: 09.03.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh M L	Sh. M. M "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Një(1) mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe 20 orë mësimore; Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Edukatës Fizike dhe shëndetësore me 10 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit nga pushimi pa pagës Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvijës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysnë, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 3 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Shkollën e Mesme të Makinerisë "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë . Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvijën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "BioFruits" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445735.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

